



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot	01-1867/15
Dep.		Bi Prot	
Dep.		Prot No	
Nr. llog.	03	Data	08-07-2015
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.07.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-860-15 për znj. Lumnije Sopi–U.D.Drejtoreshë e Teatrit Kombëtar të Kosovës, për shkak se është parandaluar konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Lumnije Sopi, është e obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt “rast për rast” të interesit, të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-860-15, për Zyrtaren e lartë, znj. Lumnije Sopi – Ushtrues e detyrës së Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës, që paraprakisht ka qenë edhe Anëtare e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.Sopi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo ka qenë në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast, është njoftuar me pretendimet që kanë ardhë nga një palë e tretë, për situatë të dyshuar për konfliktit interesi në ushtrimin e funksionit publik, duke qenë se znj.Sopi ushtronte funksionin e Anëtares së Këshillit Drejtues (KD) të Teatrit Kombëtar të Kosovës (TKK), prej nga pastaj është emëruar si ushtrues detyre e Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Në takimin me zyrtaren e lartë znj.Sopi, jemi njoftuar se ajo në pozitën e Anëtarit të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar është emëruar me Vendim të Ministrit të MKRS-së (Ref.nr.64-1-2015, te dt.12.01.2015), ndërsa në pozitën Ushtrues Detyre (U.D.) e Drejtorit të Teatrit Kombëtar

është emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ztr. Veton Firzi, (Ref.nr.731-1-2015, Dpk-Dpki-01-03-02-1181/15) për kohën prej 04.03.2015 deri në zgjedhjen e Drejtorit të ri, sipas konkursit.

Po ashtu në këtë takim znj.Sopi është deklaruar se ka marr sqarimet e nevojshëm nga zytarët kompetent të MKRS-së se ushtrimi i këtij funksioni nuk është në kundërshtim me ligjet e kësaj fushe, por me rekomandimin që të pezulloj përkohësisht funksionin e saj të deriatëhershëm si Anëtare e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar.

Meqenëse znj.Sopi këtë rekomandim të Drejtorit të Departamentit të Kulturës në MKRS nuk e ka bërë me shkrim, por vetëm deklarativisht duke mos marr pjesë më në mbledhjet e Këshillit Drejtues të TKK-së në cilësinë e Anëtares së KD-së, por vetëm në rastet kur është kërkuar si U.D. e Drejtorit të TKK-së, Agjencia kundër Korrupsion ka kërkuar nga ajo që të sjell me shkrim njoftimin për pezullimin e kësaj pozite.

Meqenëse znj.Sopi brenda afateve ligjore në AKK nuk ka sjell këtë shkresë zyrtare, AKK i ka bërë edhe shkresën Paralajmëruese (ZD-01-1423/15) me të cilën Agjencia kundër Korrupsion ka konstatuar se ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik si Anëtare e Këshillit Drejtues dhe Drejtoreshë e Teatrit Kombëtar të Kosovës përderisa nuk kemi shkresë zyrtare se ka pezulluar njërin nga këto dy funksione.

Prandaj, konform kësaj, znj.Lumnije Sopi në AKK ka sjellë shkresën njoftuese (Dpk/Dpki-03-01-1611/15) me të cilën ajo i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së me njoftimin për pezullimin e të gjitha punëve dhe detyrave të punës në pozitën e Anëtares së Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, përderisa është duke ushtruar përkohësisht detyrën e Drejtorit të TKK-së.

Po ashtu në sqarimin që ka dhënë MKRS-ja në lidhje me këtë rast është thënë se kjo Ministri është në procedurë të shpalljes së konkursit për pozitën e Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe emërimi i znj.Sopi në këtë pozitë është i përkohshëm që d.m.th. deri në zgjedhjen e drejtorit të ri, sipas konkursit (Ref.nr.2031/2015)

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar nga Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës edhe Procesverbalet e Mbledhjeve të këtij Këshilli(Z.D.01-1663/15), pas kohës së zgjedhjes së znj. Sopi për U.D. të Drejtorit të TKK-së dhe nga to ka konstatuar se znj.Sopi nuk ka marr pjesë në këto mbledhje në cilësinë e Anëtares së Këshillit Drejtues, por vetëm në cilësinë e U.D. të Drejtorit të Teatrit Kombëtar(Dpk-Dpki-03-02-1793/15).

Me këtë znj.Sopi ka parandaluar konfliktin faktik të interesit në ushtrimin e funksionit publik, por ajo është bërë me dije se mund eventualisht të ketë ndonjë situatë të konflikti të interesit “rast pas rasti”, por çka, znj.Sopi është e njoftuar me obligimin e saj ligjor për deklarim të këtyre rrethanave dhe për tërheqje nga çfarëdo lloj vendimmarrje që mund të krijoj situatë të konflikti të interesit, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit (Nr.04/L-051), neni 13, paragrafi 1,2,3.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /